

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN** - Departamenti i Krimeve të Rënda, trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Agim Ademi kryetar i trupit, dhe gjyqtarëve Zyhdi Haziri dhe Ramiz Azizi anëtarëve të trupit gjykues, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarve S.P., nga ..., për shkak të veprës penale blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2. të KPRK-ës, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat R.S., nga ..., dhe N.H., nga ..., për shkak të veprës penale blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2. të KPRK-ës, të cilin me autorizim e mbron avokat Dr. Sh.P., nga ..., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I nr.12/2017, të datës 24.01.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 04.04.2017, bie dhe në prezencë të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij publikisht shpalli këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### **I.**

*I akuzuari S.P., nga i ati D., dhe nëna J., e lindur N., i lindur me ..., në ... ku edhe jeton rr.” ... ”, nr. ..., i pa martuar, i pa punësuar, student i fakultetit ekonomik banka dhe financa, i gjendjes së dobët ekonomike, Serb, Shtetas i Republikës së Serbisë.*

## **Ë S H T Ë F A J T O R**

*Se me datë 14.01.2017, rreth orës 21,45 minuta, në pikën kufitare Kosovë-Serbi” Dheu i Bardhë” në mënyrë të paautorizuar e me qëllim shitje ka transportuar nga territori i Kosovës për në Serbi substancë narkotike të llojit “mariuhanë” në peshë prej 962.3 gram të vendosur në një qante dore – valixhe e cila është gjetur në hapësirën para ulëses së djathtë të automjetit, të markës “Opel Vektra” me ngjyrë të zezë me targa të regjistrimit ... të pronarit D.Sh. – taksist, i cili ishte duke e drejtuar të njëjtin automjet, e të cilën substancë i pandehuri S. e*

*kishte blerë në mënyrë të pa autorizuar me të njëjtën datë në ... nga një person gjerë më tani i pa identifikuar përmes D.V. nga ... i cili ka ndërmjetësuar për shitblerjen e kësaj substance narkotike.*

*-me çka ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2. të KPRK-ës.*

*Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7,17, 21, 45, 46, 69, 73, 75, 76, 83 dhe 114 të KPRK si dhe neneve 365, 453 të KPPRK-së*

## **E GJYKON**

*Të akuzuarin S.P., me dënim burgu në kohëzgjatje prej 9. (nëntë) muajve burgim si dhe dënimi me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro të cilin dënim burgu do ta vuaj përkatësisht dënim me gjobë do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgu duke i llogaritur nga 20 euro për një ditë burgim. Të njëjtit do të i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim 15.01.2017 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.*

*Të akuzuarit masa e paraburgimit do ti zgjat deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit por jo më shumë se dënimi i shqiptuar..*

*Të akuzuarit S.P. i shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i substancës narkotike të llojit "Marihuanë" në sasi prej 962.3 gram.*

*Obligohet i akuzuari që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 40 euro si dhe shpenzimet tjera sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës.*

## **II.**

*Ndaj të akuzuarit N.H., nga i ati L., dhe nëna B., e lindur A., i lindur me ..., në fshatin ..., Komuna e ..., me vendbanim të përhershëm në ..., rr." ... " nr. ..., i pa martuar, punëtor sezonal, ka të kryer shkollën e mesme-drejtimi kimi - teknologji, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.*

*Bazuar në nenin 363 par.1. pika 1.1. të KPPRK-ës.*

## **REFUZOHET AKUZA**

*Se me datë 14.01.2017 në orët e mbrëmjes në mënyrë të paautorizuar ka shitë substancë narkotike të llojit “marihuanë” në peshë prej 962.3 gr, të pandehurit S.P., nga ..., për çmimin prej 800 euro, në atë mënyrë që këtë substancë më datën e lartcekur e ka dërguar afër shtëpisë së D.V., në lagjen “ ... ” përkatësisht në një parking afër kishës në qendër të ..., ku pastaj pas arritjes të akuzuarit S., të njëjtit ia ka dorëzuar substancën narkotike duke e futur në çantën të cilën ja ka dhënë i akuzuari S. i cili pastaj e ka marrë çantën me substancën narkotike dhe e ka futur në veturë.*

*Me çka kishte me kryer veprën penale posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substanca psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2. të KPRK-ës.*

*Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.*

## **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda ka paraqitur aktakuzë PP.I.nr.12/2017, të datës 24.01.2017, kundër të akuzuarve S.P. nga ... dhe N.H., S.K. nga ..., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope ose analoge nga neni 273 par.2 të KPK-së, dhe ka kërkuar që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohet me dënim merititor sipas ligjit.*

*Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, Shaban Spahiu në fjalën përfundimtare deklaroi se heqë dorë nga ndjekja e mëtejme penale kundër të akuzuarit N.H. për shkakë të veprës penale blerje, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së ngase me prova të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë nuk ka rezultuar se i njëjti ta ketë kryer veprën penale në fjalë .Në drejtim të akuzës kemi një deklaratë të D.V. i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka qenë i sigurt në identifikimin e të pandehurit N.H., ndërsa me prova të tjera materiale si egzaminimi i gjurmëve papilare e më pas edhe nxjerrja e sms-ve telefonike si dhe listingun e ftesave telefonike e po ashtu edhe me deklaratën e të pandehurit S.P. nuk është argumentuar që i pandehuri N.H. ta ketë kryer veprën penale. Andaj në mungesë të provave të mjaftueshme heqë dorë nga ndjekja e këtij të pandehuri.*

*Sa i përket dispozitivit I që ka të bëjë me të akuzuarin S.P. bëjë përmirësimin e përshkrimit në dispozitiv në atë mënyrë që në vend të fjalëve në rreshtin e tretë të parafundit, ku thuhet nga i pandehurit N.H. duhet të jetë nga një person deri më tani i pa identifikuar . Për më tepër mbetem pranë dispozitivit I te aktakuzës ngase është vërtetuar se më datë, kohë dhe vend si ne dispozitiv i akuzuari S.P. ta ketë kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Se i akuzuari e ka kryer veprën penale vërtetohet edhe me deklaratën e tij të dhënë ne polici, prokurori e edhe ne shqyrtim gjyqësorë i cili nuk e mohon faktin se substancën narkotike të llojit “Marihuanë” në sasi prej 962.3 gram ta ketë blerë por që i njëjti ka theksuar se të njëjtën e ka pasur për konsum personal por këtë nuk e ka argumentuar me asnjë provë. Për më tepër të kundërtën e vërteton dëshmitari D.V. i cili thotë se i akuzuari S. substancën narkotike e blerë në Kosovë për shkakë çmimit më të lirë. Ashtu që i propozojë trupit gjykues që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritator sipas ligjit.*

*I akuzuari S.P. pas rregullimit – precizimit të dispozitivit I të aktit akuzues nga ana e Prokurorit të Shtetit, në këtë fazë të procedurës ka bërë pranimin e fajësisë për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope ose analoge nga neni 273 par.2 të KPK-së, të cilin pranim të fajësisë trupi gjykues e ka aprovuar, duke qenë se i akuzuari edhe në fazat e më hershme të procedurës e kishte deklaruar një gjë të tillë, se pranimi i fajësisë ishte i plotë, bindës dhe i mbështetur në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës edhe atë: raporti mbi testin fushorë të datë 15.01.2017, vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve, formular prone i datë 14.01.2017 si dhe foto dokumentacionit nga vendi i ngjarjes.*

*Mbrojtësi i të akuzuarit S.P. avokat R.S. në fjalën përfundimtare deklaroi se pasi që i akuzuari S.P. në këtë fazë të procedurës e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i është vënë në barrë dhe duke qenë se i njëjti edhe më parë gjatë procedurës ka bashkëpunuar me organet e ndjekjes, është treguar korrekt , është penduar për veprën e kryer penale, premton se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale se është i gjendjes së varfër ekonomike dhe i moshës së re, i propozojë trupit gjykues se duke i pasur parasysh këto rrethana me rastin e matjes së dënimit të i caktojë një dënim sa më të butë në mënyrë që edhe me këtë dënim të arrihet qëllimi i dënimit.*

*I akuzuari S.P. në fjalë përfundimtare deklaroi se e përkrahë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim avokat R.S. dhe shtojë se më vjen keq për veprën e kryer penale, premtoj se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale por edhe që nuk do ta konsumoj substancën narkotike, se më parë asnjëherë nuk kam qenë i gjykuar dhe në mënyrë që mos të humbas kohën për studime i propozojë trupit gjykues të më shqiptoj një dënim të kushtëzuar .*

*Mbrojtësi të akuzuarit N.H., avokat Sh.P., deklaroi se e akceptoj fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit sa i përket heqjes dorë nga ndjekja penale ndaj të mbrojturit tim, pasi që*

*prokurori i ka analizuar provat dhe me të drejtë ka konkluduar se në veprimet e të pandehurit N.H. nuk përmbushen elementet e veprës penale.*

*I akuzuari N.H., deklaroi se përkrah fjalën e mbrojtësit të tij avokat Sh.P. .*

*Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës si: raporti mbi testin fushorë të datë 15.01.2017 , vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve, formular prone i datë 14.01.2017 si dhe foto dokumentacionit nga vendi i ngjarjes, si dhe me vetë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ashtu që erdhi në përfundim se S.P., me datë 14.01.2017, rreth orës 21,45 minuta, në pikën kufitare Kosovë-Serbi” Dheu i Bardhë” në mënyrë të paautorizuar e me qëllim shitje ka transportuar nga territori i Kosovës për në Serbi substancë narkotike të llojit “mariuhanë” në peshë prej 962.3 gram të vendosur në një qante dore – valixhe e cila është gjetur në hapësirën para ulëses së djathtë të automjetit, të markës “Opel Vektra” me ngjyrë të zezë me targa të regjistrimit ... të pronarit D.Sh. – taksist, i cili ishte duke e drejtuar të njëjtin automjet, e të cilën substancë i pandehuri S. e kishte blerë në mënyrë të pa autorizuar me të njëjtën datë në ... nga një person gjerë më tani i pa identifikuar. Ashtu që në këtë mënyrë ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 lidhur me par.1 e nenin 281 par.1 pika 1.7 të KPRK-ës.*

*Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, se pranimin e fajësisë e ka bërë pa hezitim dhe në mënyrë bindëse gjithashtu i njëjti ka shprehur keqardhje të thellë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale. Po ashtu si rrethanë lehtësuese pati parasysh moshën e tij relativisht të re në faktin se është student. Si rrethanë rënduese është marrë sasia e madhe e narkotikut prej 962.3 gram dhe rrezikshmëria e veprës penale. Andaj, në prezencë të rrethanave më të shumta lehtësuese si dhe pranimin e fajësisë si rrethanë veçanërisht lehtësuese dhe mbështetur në dispozitat e neneve 75 dhe 76 të KPRK-së, të akuzuarit i shqiptoj dënim nën minimumin e paraparë ligjor, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës.*

*Gjykata refuzoj akuzën ndaj të akuzuarit N.H. bazuar në nenin 363 par.1 pika 1.1 të KPPRK-së, pasi që prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare është tërhequr nga ndjekja penale në mungesë të provave të mjaftueshme me të cilat do të argumentoheshin veprimet inkriminuese të akuzuarit .*

*Vendimi mbi shqiptimin e dënimit plotësues ndaj të akuzuarit S.P. konfiskimi i substancës narkotike të llojit “Mariuhanë” në sasi prej 962.3 gram është bazuar në nenin 69 dhe 275 par. 3 të KPRK-së*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale sa i përket dispozitivit I që ka të bëjë me të akuzuarin S.P. është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale sa i përket dispozitivit II që ka të bëjë me të akuzuarin N.H. është i bazuar në nenin 454 të KPPRK-së.*

*Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA  
PKR.nr.14/2017 Me datë. 04.04.2017**

**Sekretarja juridike,**  
Naile Neziri

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Agim Ademi

**KËSHILLA JURIDIKE:** *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krimeve të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.*